

lloj këmbët mirë, si një nënë e mirë që bën për fëmijën e saj.

Thamë se do mos vinte nonjeri në dhomë, pa Amerikaneja, me të hikurite gjindjes, me kë kë kë në buzë, u ngrit nga shtrati që të çvishet. Mirëpo u fut prapë në robat sepse atë ças hapi derën trimi i cili kish punë në dhomë. Ky mik u largua edhe pastaj zonja jonë bëri dualetën e saj të përditëshme edhe u çvesh sipas qefit të vet.

Tërë natën bëmë një gjumë të mirë ndonëse kishim ngrënë edhe pakëzë rëndë. Oda që e kuptosur mirë edhe nuk ndjemë të ftohjen e Oroshit as pak. Të nesërmet u ngritëm pakëzë von me gjithë që kishim për të matur edhe për të bërë udhë të gjatë. U çuam më këmbë, u veshmë, lamë sytë, edhe ju avitëm zjarit që kishte ndezur trimi më të gdhitë. Kafeja s' u vonua as pak.

Pas këtij formaliteti muarm instrumentat a' ona të matjes dhe dualim n' obor për të matur burrat e Oroshit. Nismë nga trimat e Kapedanit që po brithnin andej këtej. Pastaj—ndonëse u vonuan pakëzë — matëm edhe disa Oroshash të tjerë, të cilët erdhë pasi u lajmëruan prej Kapedanit. Edhe këta njerës nuk kuptonin qëllimin e matjes pa bënin ç' bënin edhe gjithë një më pyetnin.